

## KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTËS

Sot më datë 11/07/2025 ("**Data e Kontratës**") në Tiranë midis palëve të mëposhtme:

Nga njëra anë:

**Z. Bruno Sholla**, shtetas shqiptar, lindur në Kolonje, mbajtës i kartës së identitetit me numër J20103027H, me adresë, Rruga Reshit Bali, Kodra e Diellit, Selite, Tiranë , (në vijim referohet si "**Shitësi**")

Nga ana tjetër:

**Z. Sokol Qeraxhiu**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me numër H10516142M, me adresë Rr. Hodo Beg, ND P 156/4 H shk.1 Ap 9 Tiranë, administrator i shoqërisë "Prisma" sh.p.k (në vijim referohet si "**Blerësi**")

*Duke qenë se:*

- A. Shitësi zotëron një kuotë që përfaqëson 7% të kapitalit të regjistruar dhe të paguar të shoqërisë Prisma sh.p.k, regjistruar sipas legjislacionit shqiptar më 13/09/2022, me numër NIPT M22121029F dhe seli në Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika2, Nd nr 7, kati 2, Tiranë ("**Shoqëria**") me vlerë nominale totale prej 100,000 (njqinde mijë) lekë.
- B. Blerësi dëshiron të blejë kuotën e Shitësit që përfaqëson 7% të kapitalit ("**Kuota**") dhe Shitësi dëshiron të shesë tek Blerësi, Kuotën sipas kushteve dhe detyrimeve të kësaj Kontrate.

Atëherë, palët në këtë kontratë ("**Kontrata**") bien dakord si më poshtë:

### 1. OBJEKTII I KONTRATËS

- 1.1 Objekt i kësaj kontrate është shitja dhe transferimi i Kuotës në pronësi të Shitësit në Shoqëri nga Shitësi tek Blerësi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate të përcaktuar në hyrje të saj ("**Data e Kontratës**").
- 1.2 Pronësia e Kuotës kalon tek Blerësi në përputhje me kushtet dhe detyrimet e kësaj Kontrate dhe Kuota do të shitet dhe blihet së bashku me të drejtat dhe përfitimet e lidhura me to në Datën e Kontratës.





## **2. CMIMI I BLERJES SË KUOTËS DHE MËNYRA E PAGESËS**

- 2.1 Cmimi i Kuotës që do të paguhet nga Blerësi është 7,000 lekë (shtate mijë) ("Cmimi i Blerjes").
- 2.2 Blerësi do t'i paguajë Çmimin e Blerjes Shitësit në momentin e nënshkrimit të kontratës.
- 2.3 Shitësi ka përgjegjësinë e vetme për të paguar cdo tatim në lidhje me Çmimin e Blerjes.

## **3. KALIMI I PRONËSISË SË KUOTËS**

- 3.1 Pronësia mbi Kuotën në Shitje i kalon Blerësit në përputhje me Nenin 1.1.

## **4. DEKLARIMET E GARANCITË E SHITËSIT**

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton ndaj Blerësit dhe në favor të tij, se secila nga garancitë dhe deklaratimet ("Garancitë e Shitësit") në vijim janë të vërteta dhe të sakta në Datën e Kontratës.
- 4.2 Shitësi gëzon të gjithë të drejtat dhe aftësinë ligjore për të lidhur këtë Kontrate dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.
- 4.3 Kuota në pronësi të Shitësit përfaqëson 7% të kapitalit të Shoqërisë.
- 4.4 Kjo kontratë përbën një detyrim të vlefshëm ligjor mbi Shitësin dhe të detyrueshëm kundrejt tij në përputhje me kushtet e saj.
- 4.5 Nuk ekziston ndonjë marrëveshje, rregullim apo detyrim për të krijuar ose për të dhënë barrë në lidhje me Kuotën dhe asnjë person nuk ka pretenduar dhe nuk ka të drejta për barrë për ndonjë nga Kuotat në Shitje.

## **5. DEKLARIMET E GARANCITË E BLERËSIT**

- 5.1 Blerësi gëzon të gjitha të drejtat, autoritetin dhe aftësinë ligjore për të lidhur këtë Kontratë dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.

## **6. KOSTOT**

- 6.1 Secila Palë merr përsipër kostot e saj lidhur me negociatën, mbylljen dhe nënshkrimin e dokumentave të detyrueshme ligjorisht ose sipas kontratave për shitjen e Kuotës në Shitje.
- 6.2 Cdo tarifë, taksë ose tatim që duhet paguar nëse ka të tillë si rezultat i nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe i kalimit të Kuotës në Shitje, merret përsipër nga pala që është e detyruar me ligj dhe, në rast se ligji nuk përcakton se kujt pale i ngarkohen, ato ndahen në mënyrë të





barabartë midis palëve, duke përjashtuar detyrimet që i linden vetëm Shitësit sipas Nenit 2.3 të përcaktuar në këtë kontratë.

## **7. LIGJI I ZBATUESHEM**

- 7.1** Kjo Kontratë dhe marrëdhëniet midis Palëve do të rregullohen nga legjislacioni shqiptar dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet shqiptare.

## **8. JURIDIKSIONI**

- 8.1** Cdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë përsa i përket zbatueshmërisë ose vlefshmërisë do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata kompetente shqiptare.

## **9. TË NDRYSHME DHE SHITESA**

- 9.1** Asnjë ndryshim, shtesë ose tjetërsim i kësaj Kontrate nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk është me shkrim në një dokument të vetëm të nënshkruar nga ose për llogari të Palëve.
- 9.2** Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate do t'u kalojnë, në rastet e parashikuara nga ligji apo kjo kontratë, të gjithë pasuesve, zëvendësuesve ose trashëgimtareve të palëve.
- 9.3** Në rast se në çdo kohë ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, atëherë kjo dispozitë do të konsiderohet e pavarur nga kjo Kontratë dhe nëse është e mundur do të zëvendësohet nga një dispozitë e vlefshme, e cila do të shprehë, sa më afër të jetë e mundur, qëllimin e Palëve sipas kësaj Kontrate dhe aty ku është e mundur nuk do ndikojë ose dëmtojë vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e ndonjë dispozite tjetër të Kontratës.

## **10. GJUHA, KOPJET E KONTRATËS DHE HYRJA NË FUQI**

- 10.1** Kjo Kontratë hartohet në disa kopje në gjuhën shqipe, secila prej tyre do të konsiderohet origjinale, por të gjitha bashkë do të përbëjnë një dhe të njëjtën marrëveshje.

**SHITËSI**

**Bruno Shella**

**BLERËSI**

**Sokol Qeraxhiu**